



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvecen kvalitetu, standardima i uspjehu

Rezultatet përmbledhëse të vlerësimit nga pyetësi **"Studenti Mësimdhënësin"**

Semestri veror, 2023/24

1. Qëllimi i vlerësimit

Realizimi i këtij vlerësimi ka për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, në mënyrë që të arrijmë të identifikojmë sfidat e mundshme në lidhje me përmbushjen e objektivave mësimore, dhe të bëjmë përpjekje për t'i larguar ato.

2. Procesi i vlerësimit

Ashtu siç është e paraparë në kalendarin e aktiviteteve, në fund të secilit semestër, studentët plotësojnë pyetësin "Studenti – Mësimdhënësin" për të vlerësuar lëndën dhe profesorin e lëndës. Procesi i vlerësimit në të pesë njësitë akademike, për semestrin veror 2023/2024, ka filluar me datë 02 qershor dhe ka zgjatë deri me 08 qershor. Vlerësimi është bërë për profesorët dhe asistentët e secilës lëndë të ligjruar në semestrin veror të vitit akademik 2023/24. Gjatë kësaj periudhe janë vlerësuar 105 staf akademik, 73 staf të rregullt dhe 32 staf të angazhuar. Numri i pyetësorëve të plotësuar ka qenë 4229.

Këtë semestër, plotësimi i pyetësorit është realizuar përmes sistemit SEVC, gjatë periudhës së paraqitjeve të provimeve, për profesorët dhe asistentët e të pesë njësive akademike. Para fillimit të procesit të vlerësimit, i gjithë stafi akademik dhe studentët janë njoftuar për fillimin e procesit. Studentët janë njoftuar edhe me rregullat e përgjithshme të këtij procesi, duke i garantuar ata se pyetësorët janë anonim dhe se ata mund të shprehin lirshëm atë që mendojnë për secilin mësimdhënës dhe lëndë të vlerësuar. Pas përfundimit të periudhës vlerësuese, Koordinatorët/Zyrtarët e cilësisë dhe Zyra qendrore kanë përpunuar të dhënat nga ky proces, të cilat janë analizuar nga Komisionet për sigurim të cilësisë dhe vlerësim në nivel të njësive akademike dhe Këshilli për menaxhim të cilësisë dhe vlerësim në nivel qendror. Komisionet dhe Këshilli, pas analizimit të procesit, duke u bazuar në gjetjet e vlerësimit kanë dhënë rekomandime për përmirësim.

3. Rezultatet e vlerësimit

1. Studentët pohojnë se e kanë pranuar literaturën nga mësime dhënësi, ku 91% prej tyre janë përgjigjur me Po, ndërsa vetëm 9% me Jo. Rezultatet e këtij vlerësimi japin një pasqyrë të ndarjes së opinionit mes studentëve. Grupi më i madh, 91%, konfirmoi se ata kanë pranuar literaturën e lëndës nga mësime dhënësi. Në anën tjetër, vetëm 9% e studentëve raportuan se nuk kanë pranuar literaturën (figura 1).




Figura 1

2. Studentët kanë pohuar se format më të aplikueshme për pranim të literaturës janë përmes semsit dhe e-mailit, ku 48% janë deklaruar se literaturën e pranojnë përmes sems-it, ndërsa 34% përmes e-mailit. 9% janë deklaruar se literaturën mund ta gjejnë në bibliotekë, ndërsa 9% nuk e kanë pranuar në asnjë formë. Nga kjo mund të vijmë në përfundim se përveç sems-it dhe e-mailit, biblioteka duhet të pasurohet me literaturë të propozuar të programeve të studimit (figura 2).




Figura 2

3. Rezultatet tregojnë se shumica e studentëve e kanë kuptuar mirë literaturën e lëndëve. 88% e studentëve u deklaruan se materialet ishin të kuptueshme. Kjo është një shenjë e mirë që mësimmshënësit kanë arritur të prezantojnë materialet në një mënyrë që shumica e studentëve i kanë kuptuar. 6% e studentëve përgjigjën "jo" ndaj kuptueshmërisë së literaturës. Kjo tregon se ka një përqindje të vogël të studentëve që ndiejnë se materialet nuk ishin të qarta. 6% e studentëve kanë qenë neutral (figura 3).




Figura 3

4. 82% të studentëve pohojnë se janë informuar qartë për mënyrën e vlerësimit nga mësimmshënësi, 14% janë informuar pjesërisht, ndërsa 4% janë deklaruar se nuk janë informuar fare. Kjo tregon se përqindja më e madhe e mësimmshënësve në fillim të çdo semestri njoftojnë qartë studentët me mënyrën e vlerësimit (figura 4).




Figura 4

5. 80% të studentëve pohojnë se ligjëratat e shpjguara nga mësime dhënësit kanë qenë shumë të qarta, dhe kjo përqindje e lartë tregon se shumica më e madhe e studentëve janë të kënaqur me shpjegimet e ofruara nga mësime dhënësit. 16% e studentëve pohojnë se kanë qenë mesatarisht të qarta, dhe kjo tregon se ka një grup të vogël studentësh që kanë ndier se ka disa sfida të vogla në kuptimin e materialit nga ligjëratat. Ndërsa, për 4% të studentëve thonë se nuk kanë qenë të qarta ligjëratat e shpjguara nga mësime dhënësit (figura 5).




Figura 5

6. Analiza e përqindjeve të përgjigjeve tregon se shumica e studentëve kanë pasur përvoja pozitive në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve mësimore plotësuese. Përqindja më e madhe e studentëve 77% pohojnë se janë zhvilluar shumë aktivitete mësimore plotësuese. Kjo tregon se shkalla e përfshirjes së aktiviteteve të ndryshme si ushtrime, punë praktike, laboratorë, etj, ka qenë e lartë. Një përqindje më e vogël e studentëve 17% thonë se aktivitetet mësimore plotësuese janë zhvilluar mesatarisht. Kjo mund të tregojë se ndërhyrja e ndonjë aktiviteti shtesë ka ndodhur, por nuk është ndjekur në masën më të lartë. Përqindja më e ulët 6% e studentëve raportojnë se nuk janë zhvilluar fare aktivitete mësimore plotësuese (figura 6).




Figura 6

7. 83% e studentëve kanë vlerësuar që mësime mësuesit po ndjekin syllabusin dhe po ligjërojnë temat e parapara. 13% e studentëve kanë vlerësuar që mësime mësuesit po i ligjërojnë temat mesatarisht sipas syllabusit. Ndërsa, 4% janë përgjigjur me "jo", dhe kjo përqindje e ulët tregon se një numër shumë i vogël i studentëve vlerësojnë që mësime mësuesit nuk po ndjekin syllabusin (figura 7).




Figura 7

8. A ka mbajtur mësime mësuesi konsultime gjatë semestrit, 85% janë përgjigjur me "po" dhe kjo përqindje tregon se shumica e studentëve kanë mbajtur konsultime gjatë semestrit nga mësime mësuesit. 8% janë përgjigjur me "jo", edhe pse përqindja është relativisht e ulët, kjo tregon se ka një grup të vogël studentësh që nuk kanë pasur mundësi për të marrë konsultime gjatë semestrit. 7% janë përgjigjur me "nuk e di" dhe kjo përqindje tregon se një grup i vogël studentësh nuk janë të sigurtë nëse mësime mësuesit kanë ofruar konsultime gjatë semestrit (figura 8).




Figura 8

9. Pjesa më e madhe e studentëve, rreth 82% janë përgjigjur se mësime dhënësit kanë qenë shumë të gatshëm për sqarime dhe shpjegime shtesë gjatë orarit të konsultimeve. 14% janë përgjigjur me "mesatarisht i gatshëm", kjo përqindje tregon që një pjesë më e vogël e studentëve e vlerësojnë gatishmërinë e mësime dhënësit për sqarime dhe shpjegime shtesë si mesatare. Ndërsa, 4% të studentëve janë përgjigjur me "jo, nuk ka qenë i gatshëm" (figura 9).




Figura 9

10. 82% të studentëve janë përgjigjur me "po, është shumë bashkëveprues", dhe kjo përqindje e lartë tregon se shumica e studentëve vlerësojnë që mësime dhënësit janë shumë bashkëveprues gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. 14% janë përgjigjur me "është mesatarisht bashkëveprues", kjo përqindje tregon që një pjesë më e vogël e studentëve e vlerësojnë mësime dhënësit si mesatarisht bashkëveprues gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. 4% janë përgjigjur me "jo, nuk është bashkëveprues", pra një grup shumë i vogël i studentëve ka vlerësuar mësime dhënësit si jo bashkëveprues gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve (figura 10).




Figura 10

11. Se a ka ofruar mësimdhënësi shembuj praktik nga ajo çka është shpjeguar në teori, studentët janë përgjigjur si në vijim: 80% janë përgjigjur me "po", dhe kjo përqindje tregon se shumica e studentëve kanë vlerësuar që mësimdhënësi ofron shembuj praktik për të ilustruar materialet e shpjeguara në teori. 15% janë përgjigjur me "mesatarisht", kjo përqindje tregon që një pjesë e vogël e studentëve vlerësojnë mësimdhënësin si mesatarisht efikas për të ofruar shembuj praktik për të ilustruar teorinë. 5% janë përgjigjur me "jo" dhe kjo përqindje e ulët tregon se një grup shumë i vogël i studentëve nuk ka vlerësuar që mësimdhënësi ofron shembuj praktik nga materialet e shpjeguara në teori (figura 11).




Figura 11

12. 76% të studentëve kanë vlerësuar që mënyra e ligjërimit e mësimdhënësit ka ndikuar shumë në nxitjen e interesit për ligjëratat. 17% janë përgjigjur me "mesatarisht ka nxitur interesim", kjo përqindje tregon që një pjesë më e vogël e studentëve vlerësojnë mësimdhënësin si mesatarisht efikas për të nxitur interesin për ligjëratat. 7% janë përgjigjur me "jo, nuk ka nxitur interesim", kjo përqindje tregon se një grup i vogël i studentëve ka vlerësuar që mënyra e ligjërimit e mësimdhënësit nuk ka ndikuar në nxitjen e interesit për ligjëratat (figura 12).




Figura 12

Rekomandimet për përmirësim, të propozuara nga Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim:

- Nxitja e interesit përmes metodave të reja të ligjërimit.
- Përmirësimi i informimit mbi vlerësimin.
- Rritja e interaktivitetit dhe aktiviteteve plotësuese.